

VENDIM

Nr.614, datë 7.9.2011

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË NORMAVE TË TRAJTIMIT ME UNIFORMË TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve e të normave të trajtimit me uniformë për ushtarakët aktivë (oficerë, nënoficerë, ushtarë profesionistë) të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe studentët e shkollave të larta ushtarake, brenda dhe jashtë vendit, sipas pasqyrave 1-6, që u bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Kandidatët (kursantët) për nënoficerë dhe ushtarë profesionistë trajtohen me normat e ushtarit profesionist.

2. Ushtarakët e Forcave të Armatosura, të cilët dërgohen në misione ushtarake jashtë vendit, trajtohen me uniformë stërvitjeje shtesë për çdo mision, sipas natyrës dhe kushteve specifike të misionit.

3. Uniforma, gradat, shenjat dhe simbolet, që mbahen në uniformë, jepen falas për ushtarakët e përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi.

4. Ushtarakët aktivë, në momentin e daljes në rezervë apo lirim, për arsye shëndetësore, për shkak ristrukturimi apo për shkak të shkurtimeve në numrin e përgjithshëm të personelit të Forcave të Armatosura, përfitojnë falas një uniformë ceremoniale, të shoqëruar me shenjat dhe simbolet përkatëse.

5. Kur ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura apo ushtaraku në rezervë i thirrur në shërbim aktiv, humbet jetën në krye të detyrës, familjes së tij i jepen falas për ceremoninë e varrimit artikujt, si më poshtë vijon:

a) për oficerët, uniformë ceremoniale, këmishë, kollare dhe këpucë;

b) për nënoficerët dhe ushtarakët profesionistë, kostum pune, këmishë, kollare dhe këpucë.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

7. Vendimi nr.464, datë 2.7.2004 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kritereve dhe të normave të trajtimit me uniformë të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", shfuqizohet.

8. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

PASQYRA NR.1

NORMAT E ARTIKUJVE TË UNIFORMAVE USHTARAKE PËR OFICERËT

PASQYRA NR.2

NORMAT E ARTIKUJVE TË UNIFORMAVE USHTARAKE PËR NËNOFICERËT

PASQYRA NR.3

**NORMAT E ARTIKUJVE TË UNIFORMAVE USHTARAKE PËR USHTARËT DHE
DETARËT PROFESIONISTË**

PASQYRA NR.4

**NORMAT E ARTIKUJVE TË UNIFORMAVE USHTARAKE PËR ORKESTRËN FRYMORE
TË FORCAVE TË ARMATOSURA**

PASQYRA NR.5

**NORMAT E ARTIKUJVE TË UNIFORMAVE USHTARAKE PËR STUDENTËT
USHARAKË**

PASQYRA NR.6

**NORMAT E ARTIKUJVE TË UNIFORMAVE USHTARAKE PËR USHTARAKËT QË
SHKOJNË NË MISIONE JASHTË VENDIT**